

## **SKEMA E MINI-GRANTEVE PER PROJEKTIN: “PERMIRESIMI I STATUSIT USHQIMOR TE FEMIJEVE TE SHKOLLES NE SHQIPERI”**

### **I. Përshkrim i projektit**

Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike (ACER) është duke zbatuar projektin “**Përmirësimi i Statusit Ushqimor të Fëmijët (6-15 vjeç) në Shkollë, në Shqipëri**” i cili financohet nga UNICEF në periudhën kohore Korrik 2020 - Nëntor 2021. Projekti zbatohet në katër rajone (Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Korçë) dhe ka si synim përmirësimin e ushqyerjes të fëmijët (6-15 vjeç) në shkollë.

### **2. Skema e Granteve të Vogla (SGV)**

Aplikimi i skemës së granteve të vogla në rajonet e Shqipërisë ku po zbatohet projekti: është një nga komponentët specifikë të projektit. Kjo skemë ofron mundësinë e aplikimit për grante të vogla të cilat mund të varjojnë nga 300-1200 USD, për 8 grante në 4 qytete Tiranë, Vlorë, Korçë dhe Durrës (2 për çdo qytet) për të mbështetur projekte domethënëse me zbatime aktiviteteve që synojnë edukimin, frymëzimin dhe stimulimin e interesit për të mësuar rreth të ushqyerit dhe inkurajimin e zakoneve të shëndetshme të të ngrënit në shkollë dhe në familje, si dhe të motivojë nxënësit për të ndryshuar sjelljen e tyre me impakt në parandalimin dhe reduktimin e obezitetit dhe formave të tjera të kequshqyerjes së fëmijëve të moshës shkollore. Preferohet që pjesëmarrësit të mësojnë rreth të ushqyerit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve argëtuese dhe përfshirëse

#### **2.1 Përshkrimi i skemës së mikro-granteve**

Zbatimi i skemës së granteve të vogla në disa rajone të Shqipërisë është një nga komponentet specifike të projektit “Përmirësimi i Statusit Ushqimor të Fëmijëve të Shkollës në Shqipëri”.

Projekt-propozimet fituese do të përzgjidhen nga një komitet përzgjedhëse, që përfshinë përfaqësues nga ekipi i projektit, shkollat pjesëmarrëse, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë. Qëllimi i mikro-granteve të vogla është të fuqizojë dhe mbështetëse grupet ekzistuese me bazë komunitare, OJF lokale që kanë partneritet me shkollat si qendra komunitare për të zhvilluar mini-projekte të vogla që adresojnë problematikat dhe nevojat reale të komunitetit të nxënësve dhe të mësuesve në adresimin e çështjes së ushqimit dhe ushqyerjes së shëndetshme. ACER do të ofrojë mbështetje metodologjike, teknike dhe menaxheriale për zbatimin e mini-projekteve dhe zhvillimin organizativ të grupeve aplikante të nxënësve dhe mësuesve në arritjen e rezultateve të tyre. Në këtë mënyrë një proces ndërtim kapacitetesh në nivel shkolle, do të zbatohet nëpërmjet këtyre projekteve fituese.

Rritja e njohurive themelore mbi ushqimin dhe ushqyerjen, është një aspekt i rëndësishëm i këtij program që synon që nxënësit dhe mësuesit, në bashkëpunim me për organizatat lokale të shoqërive civile dhe njësitë e qeverisjes vendore të bazojnë aplikimin e vet duke u mbështetur në nevojat e secilit grup aplikant. Ky proces do të fillojë që në momentin kur ata përzgjidhen si fitues me idenë që do të paraqesin, për të vazhduar me burimet dhe nevojat, proces që do të lehtësohet nga ekipi menaxhues i projektit.

## 2.2 Kriteret e përzgjedhjes

Në mënyrë që të rrisin mundësinë për përzgjedhje cdo ekip nxënësish dhe mësuesish mbi bazë shkolle duhet të ketë parasysh në dorëzimin e aplikimit përmbushjen e këtyre kriterëve të përzgjedhjes:

- a. **Impakti që përkon me objektivin edukues të projektit:** Ndërtimi ose fuqizimi i një rrjeti edukues në funksion të ushqimit dhe ushqyerjes së shëndetshme të fëmijëve, në çdo rajon të përfshirë në projekt.
- b. **Rezultatet e pritshme në aspektin parandalues të obezitetit:**
  - Identifikimi i rreziqeve nga ushqimet e pakkontrolluara apo çdo forme tjetër të keq-ushqyerjes përmes ndërgjegjësimit dhe rolit më aktiv të fëmijëve dhe komuniteteve vulnerabël, veçanërisht të fokusuar kundrejt këtyre të fundit.
  - Njohja dhe promovimi i potencialeve ushqimore të zonës, traditës, etj. në funksion të ushqyerjes së shëndetshme të fëmijëve;
  - Edukimi përmes modeleve të suksesshme në ushqimin dhe ushqyerjen e shëndetshme dhe provimi i këtyre modeleve nga personeli arsimor i mirëtrajnuar dhe ndërgjegjësuar si dhe të vetë grupeve të fëmijëve.
  - Njohja dhe promovim i shërbimeve me bazë komunitare dhe bashkëveprimi me njësitë e qeverisjes vendore për të edukuar dhe parandaluar riskun e obezitetit tek fëmijët e moshës shkollorë dhe nxitja e solidaritetit shoqëror për të ofruar një alternative pozitive përkundrejt atyre që vijnë nga familje në vështirësi.
- c. **Planifikimi:** Planifikimi përfshin informacion të hollësishëm mbi zbatimin.
  - Të marrë parasysh aktivitete të tjera që po zbatohen njëkohësisht në rajonin përkatës për të mos lejuar mini-projekte/ projekte të ngjashme,
  - Propozimi të përfshijë një plan-monitorimi të rezultateve duke bazuar me indikatorë të parashikuar.
  - Organizata/grupet komunitare dhe /ose mësuesve kanë eksperiencën e nevojshme në zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe fuqizuese me grupet e fëmijëve dhe të të rinjve;

Përvoja e mëparshme në aktivitete ndërgjegjëse në komunitet përbën një avantazh konkurrues.

## 2.3 Kush mund të aplikojë dhe përdorimi i grantit

- Individët/ Organizata të shoqërisë civile edhe / ose grupet komunitare që punojnë në fushën e edukimit dhe ndërgjegjësimit publik si dhe drejtpërdrejt me fëmijët dhe të rinjtë me fokus në aktivitetet për çështje të shëndetit.
- Organizatat aplikuese/ Individit duhet të jenë me bazë lokale domethënë të punojnë dhe të jenë të vendosura në komunitetin e rajonit ku punojnë.
- Aplikantët duhet të jenë në gjendje të demostrojnë kapacitete menaxhuese (njerëzore dhe asete si një sistem raportimi periodik, telefon apo akses në email).
- Një kopje e CV së organizatës/ aplikantit duhet të shoqërojë aplikimin.
- Aplikantët duhet të provojnë se kanë përvojë të mëparshme në organizimin e veprimtarive edukative në komunitetin shkollor.
- Këto mini-grante nuk mund të shfrytëzohen për formalizimin e një organizate apo themelimin e një organizate të re.
- Mini-granti nuk mund të përdoret për pagesa administrative (psh pagesa stafi, shpenzime qera, drita, etj).
- Ky grant nuk mbështet zyra apo degë të partive politike si dhe institucione shtetërore.
- Një individ/organizatë nuk mund të aplikojë për më shumë se një grant.

## 2.4 Fusha e aplikimit

Në aplikimin tuaj për mini-grante, ju mund të zgjidhni një nga idetë e mëposhtme ose jeni të mirëpritur të propozoni ide të reja:

- Festa e shëndetit
- Të kuptojmë obezitetin
- Debati mbi Dietën
- Zbuloni mangësitë
- Zbuloni ushqime të fortifikuara
- Mjeshtri i menysë
- Inspektoni kuzhinën tuaj
- Mania e vaktit
- Mëso të bësh Pazar
- Skiconi një jetë akoma sezonale
- Mbillni perimet tuaja
- Kur kurseni ushqimin bëni një punë të mirë
- Kontrolli i etiketave
- E hëna pa mish
- Lokale vs. e Importuar

## 3. Procedura e aplikimit

Aplikimi realizohet me anë të dorëzimit të:

- Formatit të aplikimit dhe CV e aplikantit/organizatës
- Formulari i aplikimit, bazuar në udhëzimet e mësipërme të mikro-granteve, duhet të plotësohet dhe të dërgohet brenda një afati 10 ditor (18 Maj - 28 Maj 2021), elektronikisht në adresën: serjanajbylyre@gmail.com

Për sqarime të mëtejshme, vizitoni faqen e ACER në facebook (Albanian Center for Economic Research) dhe faqen e Internetit: [www.acer.org.al](http://www.acer.org.al), si dhe kontaktoni me zyrën e ACER:

- Tel: +355 4 535 2005
- Cel: +355 68 9011 619
- E-mail: [serjanajbylyre@gmail.com](mailto:serjanajbylyre@gmail.com)

### 3.1 Afatet e procedurës së aplikimit dhe zbatimin e Mini-Projekteve

Procedura e aplikimit do të zhvillohet në këto faza:

- **Faza për zgjedhëse:** Në këtë fazë, idetë e propozuara që janë dorëzuar do të shqyrtohen nga ekipi menaxhues i projektit dhe do t'u shpërndahen për vlerësim Komitetit Vlerësues. Projektet fituese do të njoftohen me e-mail më 2 Qershor 2021.
- **Faza e kontraktimit:** Aplikantët të cilët janë përzgjedhur do të ftohen të dorëzojnë dokumentacionet shtesë si Vendimin e gjykatës dhe Statutin e organizatës (nëse aplikanti është një organiztë), NIPT/numrin e taksueshëm (për organizatat e rregjistruara) dhe më pas do të firmosin marrëveshjet dhe kontratat e bashkëpunimit me ACER (05 -10 Qershor 2021)
- **Zbatim i mini-projekteve** do të bëhet për një periudhë deri në katër muaj: 11 Qershor– 11 Tetor 2021
- **Raportimi perfundimtar** 20 Tetor 2021.

*Aplikantët potencial të cilët kanë pyetje apo janë të paqartë në lidhje me pranueshmërinë e një ideje të propozimit për një projekt apo cdo paqartësi tjetër duhet ta diskutojnë këtë çështje paraprakisht me ekipin menaxhues të projektit.*

## Aneks I: Formular aplikimi per grante te vogla

**Data e aplikimit:** \_\_\_\_\_  
**Qyteti:** \_\_\_\_\_  
**Shkolla** \_\_\_\_\_ (nese aplikanti vjen nga nje shkolle e caktuar)

Formulari i meposhtem se bashku me CV e organizates, bazuar ne udhezimet e Skemes se Granteve te Vogla te projektit “**Përmirosimi i Statusit Ushqimor te Fëmijët (6-15 vjeç) në Shkolla, në Shqipëri**”, duhet te plotesohet dhe te dergohet brenda afateve te caktuara 18 Maj - 28 Maj 2021, elektronikisht ne [serjanajbylyre@gmail.com](mailto:serjanajbylyre@gmail.com)  
Per sqarime te metejsme, vizitoni faqen tone ne facebook dhe faqen e i internetit: acer.org.al si dhe kontaktoni me zyrtar e ACER; Tel: +355 4 535 2005, E-mail: [serjanajbylyre@gmail.com](mailto:serjanajbylyre@gmail.com)

<b>I. Detajet e Aplikantit</b>
Kategoria e Aplikantit: (sheno vetem nje nga kategorite) A. Shoqate/organizate B. Koalicion organizatash C. Shoqate/organizate se bashku me grup komunitar D. Individ
Emri i individit ose i personit te kontaktit te organizates: Pozicioni: Adresa Postare: Telefoni: _____ Celulari: _____ Adresa Email: _____
Nese ka, pershkrim i shkurter i grupit komunitar qe eshte bashke-aplikues dhe aktivitetit te tij:
<b>2. Informacion baze per Projektin (hapesirat me poshte mund te zgjerohen per te dhene pergjigjet e duhura)</b>
Titulli i Projektit:
Qellimi dhe Objektivat:
Afatet kohore te aktiviteve (Data e fillimit dhe te mbarimit):
Pershkrim i shkurter i projektit dhe lista e aktiviteve:
Rezultati i pritshem i aktivitetit dhe i indikatorve qe do te perdoren per te matur rezultatet? (Sigurohuni qe treguesit mund te maten realisht dhe te raportohen ne kontekstin e aktivitetit te propozuar).
Racionale: Ju lutemi thoni se pse ky projekt duhet te mbeshtetet.

Perfituesit e parashikuar te projektit:		
<b>3. Kosto e Aktivitetit</b>		
Zerat kryesore te buxhetit		
Granti total i kerkuar		
Kontributi financiar eventual i organizates suaj (nese ka)		
Totali i buxhetit te pergjithshem te aktiviteve		
Nese aprovohet ky grant a do te jete i mjaftueshem per te perfunduar kete aktivitet?		PO/JO
<b>4. Vertetimi</b>		
<p>Une/ne vertetojme se informacioni i dhene ne kete aplikim eshte i vertete dhe i sakte.</p> <p>Une/ne pajtohemi qe ne perfundim te aktiviteve te dorezojme nje raport te plote per realizimin e fondeve te grantit dhe nje raport perfundimtar te projektit ne baze te marreveshjes se miratuar me pare.</p> <p>Une/ne jemi dakord per te marre pjese ne anketat dhe/ose intervistat ne lidhje me rezultatet/ndikimin qe granti ka pasur ne proceset zhvillimore ne qarkun tone.</p>		
Emri:	Pozicioni:	Numri i Kontaktit:
Firma:		Data:
Nese formulari paraqitur nga bashkesi organizatash, te gjitha perfaqesuesit (organizatat) e perfshira duhet te firmosin ketu:		Data: